



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2021:275169  
Datë: 26.04.2024  
Numri i dokumentit: 05628954

KPPP.nr.1980/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit A.B. B.I., (N.P.Sh “Arianit”-A), me seli në Gjilan, rruga “Adem Jashari” pn, me NUI:810260109, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arton Haziri avokat nga Gjilani, kundër debitorit Komuna e Gjilanit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.377/21 të datës 05.11.2021, të Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 04.04.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Gjilanit, i paraqitur kundër Urdhrit P.nr.377/21 të datës 05.11.2021, të nxjerrë nga Përmbartuesi Privat Kushtrim Musa, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.
- II. Detyrohet debitori që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi t’ia paguaj kreditorit shpenzimet e procedurës në këtë gjykatë sipas prapësimit të debitorit në shumë të përgjithshme prej 208 €, në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim nga avokati.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, me Urdhrit Përmbartimor P.nr.377/21 të datës 05.11.2021, e ka caktuar përmbartimin ndaj debitorit në bazë të dokumenteve të besueshme–faturave dhe atë: faturës

nr.36/2018 të datës 31.10.2018 në shumën prej 11,513.58 Euro, faturës nr.37/2018 të datës 31.10.2018 në shumën prej 1,302.05 Euro, që brenda afatit prej 7 ditëve t'ia paguaj borxhin kreditorit me kamatëvonesë prej 8 % nga data 31.10.2018 e deri në pagesën definitive, si dhe në bazë të faturës nr.40/2018 të datës 30.11.2018, në shumën prej 1,302.05 Euro, faturës nr.41/2018 të datës 30.11.2018 në shumën prej 11,513.58 Euro, me kamatëvonesë prej 8 % nga data 30.11.2018 deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës së përmbarrimit, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër urdhrin të Përmbarruesit Privat, brenda afatit të rregullt ligjor debitori ka ushtruar prapësim, me arsyetimin se propozimit për përmbarrim i mungojnë argumentet juridike përmes të cilës do të cilësohej si dokument i besueshëm dhe ekzekutiv pasi nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet konform nenit 29 pikës 1, paragrafit 1.3 dhe pikës 3 të të njejtin nen. Më tej ka shtuar se objekti i procedurës së përmbarrimit është në kundërshtim edhe me udhëzimin administrativ nr.15/2010 për zbatimin e ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat, ku në nenin 20, paragrafi 1.1.17 parashikohet që faturat duhet të jenë të nënshkruara dhe vetëm si të tilla prodhojnë obligime reciproke. Ka theksuar se faturat të cilat janë objekt i propozimit nuk janë pranuar dhe nënshkruar asnjëherë nga zyrtarët kompetent të Komunës së Gjilanit, andaj Përmbarruesi Privat propozimin për përmbarrim e ka bazuar në faturat kopje dhe të panënshkruara. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të përfundohen/anulohen të gjitha veprimet në lidhje me këtë propozim për përmbarrim.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se faturat i janë dorëzuar Përmbarruesit Privat në origjinal dhe si të tilla gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa për palën tjetër ato kanë qenë në kopje. Më tej ka shtuar se kërkesat e ATK-së lidhur me faturat nuk ndikojnë fare në cilësinë e faturës për të qenë dokumenti i besueshëm ngase LPP i ka përcaktuar qartë kriteret që duhet t'i plotësoj një faturë për të qenë dokument i besueshëm. Kreditori po ashtu ka theksuar se në shkresat e lëndës gjenden edhe fletëkthesat e postës, me të cilat vërtetohet se debitori përmes zyrtarëve të saj i ka pranuar faturat. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit, ndërsa të vërtetohet urdhri për përmbarrim, si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale për propozimin për përmbarrim në shumë prej 208 Euro, dhe përgjigjen në prapësim në shumë prej 208 Euro, të cilat llogariten në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve, si dhe shpenzimet procedurale të krijuara pranë Përmbarruesit.

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktvendimin CPK.195/21 të datës 10.05.2022, e ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit, dhe e ka shfuqizuar urdhrin e Përmbarruesit Privat sa i përket shumës 12,815.63 Euro, ndërsa e ka lënë në fuqi urdhrin sa i përket shumës prej 12,815.63

Euro.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të ankesës së kreditorit dhe të debitorit, të njejtat ankesa i ka aprovuar si të bazuara, dhe e ka anuluar aktvendimin e shkallës së parë duke e kthyer çështjen në rivendosje. Kjo gjykatë ka vlerësuar se aktvendimi i shkallës së parë është marr në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave ligjore, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka dështuar që të administrojë saktë provat që gjenden në shkresat e lëndës. Në riprocedurë, e ka udhëzuar gjykatën e shkallës së parë që t'i evitojë shkeljet dhe të ndërmer veprime përkatëse për sqarimin e fakteve.

Gjykata në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit, deklarimeve në përgjigje në prapësim të kreditorit, dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata, nga shkresat e lëndës, ka evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbarim dokumentin e besueshëm/faturat dhe atë : faturën nr.36/2018 të datës 31.10.2018 në shumën prej 11,513.58 Euro, faturën nr.37/2018 të datës 31.10.2018 në shumën prej 1,302.05 Euro, faturën nr.40/2018 të datës 30.11.2018 në shumën prej 1,302.05 Euro, dhe faturën nr.41/2018 të datës 30.11.2018 në shumën prej 11,513.58 Euro, të cilat janë dorëzuar në origjinal së bashku me propozimin. Ato përmbajnë të dhëna për kreditorin dhe debitorin, numrin e faturës, datën e faturimit, si dhe objektin, llojin, shumën, mirëpo në këtë fatura mungon nënshkrimi i debitorit. Megjithatë, nga fletëkthesat e postës së rregullt të bashkëngjitura në shkresat e lëndës rezulton se debitori i ka pranuar faturat e lartcekura nga kreditori me anë të postës së rregullt, pasi secila nga këto fletëkthesa përmban nënshkrimin e pranimit të debitorit, si dhe të dhënat për secilën nga faturat në bazë të të cilave është lëshuar urdhri për përmbarim. Prandaj, gjykata

vlerëson se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme.

Bazuar në të lartcekurat gjykata konstaton se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 dhe 463 par.1 dhe 2 të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së. Gjykata e gjeti si të bazuar kërkesën e kreditorit për pagesë të shpenzimeve sa i përket përpilimit të përgjigjes në prapësim, ndërsa lartësinë e saj gjykata e llogariti duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve të nxjerrë nga Oda e Avokatëve më 18 mars 2017, siç përcakton neni 453 para. 2 LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, ashtu që si bazë u mor lartësia e vlerës së përmbarimit, numri i palëve të përfaqësuar, si dhe lloji i veprimit procedural për të cilin janë kërkuar shpenzimet.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1980/23, me datë 04.04.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.